



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGJENCIA ZA STATISTIKU KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ReKos 2024



Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

PROFILI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë,
Ekonomive Familjare dhe Banesave

2024



POPULLSIA



EKONOMITË
FAMILJARE



BANESAT



Prishtinë, Korrik 2026

PROFILI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Botues: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Korrik 2026
© Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

PËRMBAJTJA

	Faqe
Fjalë hyrëse	2
Parathënie	3
KAPITULLI 1	4
1.1. Aspektet administrative	4
KAPITULLI 2	8
2.1. Karakteristikat e njësive të banimit	8
KAPITULLI 3	12
3.1. Karakteristikat e ekonomive familjare	12
KAPITULLI 4	15
4.1. Madhësia dhe struktura e popullsisë	15
KAPITULLI 5	20
5.1. Karakteristikat sociale dhe ekonomike.....	20
KAPITULLI 6	27
6.1. Përmbledhje e treguesve të përzgjedhur	27
Tab. 1 - Popullsia, dendësia dhe urbanizimi sipas komunave, 2024.....	28
Tab. 2 - Kushtet e banimit sipas komunave, 2024.....	29
Tab. 3 - Karakteristikat e ekonomive familjare sipas komunave, 2024	30
Tab. 4 - Ndryshimet demografike sipas grupmoshave dhe komunave, 2011 dhe 2024.....	31
Tab. 5 - Karakteristikat socio-ekonomike të popullsisë sipas komunave, 2024.....	32
Fjalor i Termave	35

Fjalë hyrëse

Të nderuar lexues,

Raporti "Profili i Kosovës 2024", është një dokument gjithëpërfshirës që përgatitet për herë të parë duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe të bazuar në fakte mbi karakteristikat demografike, sociale, ekonomike dhe të banimit të Republikës së Kosovës. Ky publikim është përgatitur mbi bazën e rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, operacioni më i madh statistikor i realizuar në vend dhe burimi më i rëndësishëm i të dhënave zyrtare për planifikimin dhe zhvillimin afatgjatë.

Profili i Kosovës paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe të kuptueshme ndryshimet që kanë ndodhur në vend gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve, duke ofruar informacione mbi madhësinë dhe strukturën e popullsisë, urbanizimin, kushtet e banimit, karakteristikat e ekonomive familjare, arsimin, tregun e punës dhe tregues të tjerë me rëndësi për zhvillimin e vendit. Këto të dhëna reflektojnë transformimet demografike dhe socio-ekonomike që po formësojnë shoqërinë tonë dhe paraqesin bazë të domosdoshme për politika publike të informuara dhe vendimmarrje të qëndrueshme.

Rezultatet e paraqitura në këtë publikim dëshmojnë se Kosova po kalon procese të rëndësishme zhvillimore, të karakterizuara nga ndryshime në strukturën moshore të popullsisë, rritja e urbanizimit, përmirësimi i kushteve të banimit dhe transformime në tregun e punës. Njëkohësisht, ato nxjerrin në pah sfidat që lidhen me rënien e popullsisë, plakjen demografike dhe nevojën për politika të përshtatura ndaj realiteteve të reja shoqërore dhe ekonomike.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbetet e përkushtuar për të prodhuar statistika cilësore, të besueshme dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, duke u shërbyer institucioneve publike, komunitetit akademik, sektorit privat, organizatave ndërkombëtare dhe gjithë përdoruesve të statistikave zyrtare. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një referencë e rëndësishme për analizën e zhvillimeve aktuale dhe planifikimin e së ardhmes së Kosovës.

Shpreh mirënjohjen tone për të gjithë qytetarët që kontribuan në Regjistrimin 2024, mbështetjen nga Qeveria, komunat, kontributin e çmuar për stafin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ekspertët vendorë e ndërkombëtarë dhe partnerët institucionalë që mbështetën realizimin e këtij procesi dhe përgatitjen e këtij publikimi.

Avni Kastrati
Drejtor Ekzekutiv
Agjencia e Statistikave të Kosovës

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka realizuar Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024. Regjistrimi është zhvilluar nga data 5 prill deri më 24 maj 2024, ndërsa momenti kritik i regjistrimit ka qenë data 04-05 prill 2024, ora 24:00, e cila shënon referencën për të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë këtij procesi.

Objektivi ynë është që këto të dhëna të prezantohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe vizualisht tërheqëse për të mundësuar përdorim sa më të gjerë dhe efektiv të tyre.

Të gjitha tabelat dhe përmbledhjet statistikore të përfshira në këtë publikim janë krijuar drejtpërdrejt nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit 2024, pas përpunimit të nevojshëm logjik, formal, teknik, tabelar dhe grafik. Përpunimi i të dhënave është kryer me kujdes maksimal për të garantuar saktësinë, përputhshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve.

ASK-ja, thekson rëndësinë e shfrytëzimit të shpjegimeve metodologjike të përfshira në këtë publikim, të cilat janë të domosdoshme për interpretimin e drejtë dhe të saktë të të dhënave. Kuptimi korrekt i këtyre statistikave është thelbësor për formulimin e politikave publike, planifikimin zhvillimor dhe hulumtimin shkencor.

ASK-ja shpreh mirënjohjen e saj për ndihmën dhe mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në përgatitjen e këtij dokumenti.

Ky Regjistrim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të Sistemit Statistikor të Kosovës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të statistikave zyrtare në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të vendit.

Publikimin përgatitën:

Ylli Shala - Menaxher i Regjistrimit të Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2024
Bekim Canolli - Drejtor i Departamentit të Metodologjisë dhe IT
Burim Limolli - Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative

Eduard Jongstra - Konsulent ndërkombëtar, mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Idriz Shala - Ekspert për GIS
Burim Gashi - Specialist për GIS dhe Hartografi
Valdete Navakazi - Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë
Bujar Hajrizi - U.d. Udhëheqës i Divizionit të Statistikave Sociale
Arjeta Sojeva - Zyrtare e lartë për statistika vitale
Mentor Shala - Ekspert i TI-së
Advie Uka - Zyrtare për statistika të arsimit
Drita Sylejmani - Zyrtare e lartë e Diseminimit
Arlinda Kosumi - Zyrtare për lektorim

Korrik, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së

Avni Kastrati

KAPITULLI 1


1.1. Aspektet administrative

Republika e Kosovës mbulon një sipërfaqe totale prej 10,905 km², nga e cila 247 km², ose 2.3 % është e përcaktuar si zonë urbane. Në kohën e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, zona urbane në Kosovë ishte 187 km², ose 1.7 % e sipërfaqës totale të Kosovës.

Popullsia e Kosovës ka shënuar rënie ndërmjet regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024, duke u ulur nga gjithsej 1 739 825 banorë në vitin 2011 në 1 585 566 banorë në vitin 2024. Megjithatë, popullsia që jeton në zonat urbane ka shënuar rritje nga 38.0 % sa ishin në vitin 2011 në 50.2 % në vitin 2024.

Kjo rritje ishte kryesisht për shkak të zgjerimit të zonës urbane me plane zhvillimore, por edhe për shkak se disa vendbanime janë trajtuar si urbane me kriteret statistikore.

Fig. 1: Popullsia urbane dhe rurale, 2011 dhe 2024




Rënia e numrit të popullsisë në Kosovë pasqyrohet edhe në uljen e dendësisë së popullsisë në zonat urbane dhe rurale. Në nivel kombëtar, dendësia mesatare e popullsisë ka rënë nga 163 banorë për km² në vitin 2011 në 147 banorë për km² në vitin 2024. Në zonat urbane, dendësia e popullsisë ka shënuar rënie nga 3,644 në 3,190 banorë për km², ndërsa në zonat rurale ka rënë nga 102 në 76 banorë për km² gjatë së njëjtës periudhë.

Harta. 1: Komunat e Kosovës, 2024¹




¹ Hartat janë përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës duke përdorur kufijtë administrativë dhe zonat kadastrale në fuqi në kohën e realizimit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024.

Harta. 2: Dendësia e popullsisë sipas komunave, 2024



Harta. 3: Dendësia e popullsisë sipas zonave kadastrale (vendbanimeve), 2024



KAPITULLI 2

2.1. Karakteristikat e njësive të banimit

Në vitin 2011, Republika e Kosovës kishte gjithsej 412,884 njësi banimi, prej të cilave 175,791 ose 42.6 % ndodheshin në zonat e saj urbane. Deri në vitin 2024, numri i përgjithshëm i njësive të banimit ishte rritur në 581,095 prej të cilave 312,937 ose 53.8 % në zonat urbane.

Nga 175,791 njësi banimi në zonat urbane, 126,056 ose 71.7 % u raportuan si “të banuara” në vitin 2011. Regjistrimi i vitit 2024 shënoi gjithsej 189,682 njësi banimi si “të banuara” në zonat urbane të Kosovës, ose 60.6 %. Në pjesët rurale të Kosovës, ndërmjet viteve 2011 dhe 2024 njësitet e banimit kishin pësuar rënje nga 70.6 % në 62.4 %.

Përderisa numri i banorëve në zonat urbane dhe rurale të Kosovës ka rënë, numri i njësive të banimit është rritur ndërmjet regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024. Kjo rezultoi në ulje të ndjeshme të raportit ndërmjet popullsisë dhe njësive të banimit, edhe kur merren parasysh vetëm njësitet e banuara. Në vitin 2011, numri mesatar i personave për njësi banimi të banuar në zonat urbane në Kosovë ishte 5.2 Deri në vitin 2024, ky numër kishte rënë në 4.2, Në zonat rurale pati një rënie të ngjashme, nga 6.5 në 4.7 persona për njësi banimi të banuara.

Fig. 2: Shkalla e banimit të njësive të banimit, 2011 dhe 2024





Fig. 3: Popullsia për njësi banimi të banuara, 2011 dhe 2024



Ndërmjet regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024, numri mesatar i dhomave në njësitet e banimit në Kosovë është rritur lehtë, nga 4.0 në 4.1 dhoma për njësi banimi (duke pasur parasysh se kuzhinat, tualetet dhe hapësirat e magazinimit nuk janë llogaritur si dhoma). Sipas regjistrimit të vitit 2024, në këtë aspekt kishte pak dallim ndërmjet zonave urbane dhe rurale të Kosovës. I njëjti model vërehet edhe te numri mesatar i personave për dhomë. Në vitin 2011, ky tregues ishte 1.6, ndërsa në regjistrimin e vitit 2024, ky numër kishte rënë në 1.0. Në pjesët rurale ishte pak më i ulët, me 0.9 persona për dhomë.

Fig. 4: Numri mesatar i dhomave për njësi banimi, 2011 dhe 2024





Fig. 5: Numri mesatar i personave për dhomë, 2011 dhe 2024



Në vitin 2011, 69.7 % e të gjitha njësive të banimit në Kosovë kishin qasje sistemin publik të furnizimit me ujë të pijshëm. Ndërsa në vitin 2024, kjo përqindje ishte rritur në 76.3 %. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në ujë ka rënë nga 0.7 % në vitin 2011, në 0.2 % në vitin 2024.

Fig. 6: Furnizimi me ujë, 2011





Fig. 7: Furnizimi me ujë, 2024



Regjistrimi i vitit 2024 evidentoi dallime të konsiderueshme në llojet e furnizimit me ujë ndërmjet zonave urbane dhe rurale të Kosovës. Në zonat urbane, 94.6 % e njësive të banimit kishin qasje në sistem publik të furnizimit me ujë, ndërsa në zonat rurale kjo përqindje ishte 55.5 %.

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, në Kosovë u shënuan përmirësime të mëdha në sistemin e kanalizimit. Qasja në sistemin publik të kanalizimit është rritur nga 57.4 % në 86.1 % të

të gjitha njësive të banimit. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në asnjë sistem kanalizimi ka rënë nga 4.3 % në 0.9 %.

Sipas regjistrimit të vitit 2024, në zonat urbane të Kosovës, 97.6 % e njësive të banimit kishin qasje në rrjetin publik të kanalizimit, krahasuar me 73.1 % në zonat rurale.

Fig. 8: Kanalizimi, 2011





Fig. 9: Kanalizimi, 2024



Shumica dërmuese e njësive të banimit në Kosovë kanë qasje në tualet me shpërlarje mbrenda njësisë së banimit. Në vitin 2011, 87.8 % e të gjitha njësive të banimit kishin tualet të brendshëm me shpërlarje. Deri në vitin 2024, kjo përqindje ishte rritur në 97.6 %. Përqindja e njësive të banimit pa tualet me shpërlarje ra nga 4.9 % në 1.3 %, ndërmjet viteve 2011 dhe 2024.

Regjistrimi i vitit 2024 ka shënuar shumë pak dallime ndërmjet njësive të banimit në Kosovë sa i përket disponueshmërisë së tualeteve të brendshëm me shpërlarje. Në pjesët urbane, 98.9 % e njësive të banimit kishin qasje në tualet të brendshëm me shpërlarje, krahasuar me 96.1 % të njësive të banimit në zonat rurale. Përqindja e njësive të banimit pa qasje në tualet me shpërlarje në zonat rurale të Kosovës ishte 2.1 %, ndërsa në zonat urbane ishte 0.5 %.

Fig. 10: Tualet me shpërlarje, 2011





Fig. 11: Tualet me shpërlarje, 2024



Lëndët djegëse (druri, qymyri ose nafta) kanë mbetur burimi kryesor i ngrohjes për njësitë e banimit në Kosovë. Në vitin 2011, 94.3 % e të gjitha njësive të banimit përdornin lëndë djegëse për ngrohje, ndërsa deri në vitin 2024 kjo përqindje ka rënë në 64.5 %. Ky ndryshim është shkaktuar kryesisht nga rritja e përdorimit të energjisë elektrike si burim ngrohjeje, e cila është rritur nga 5.2 % në vitin 2011 në 30.0 % në vitin 2024.

Sa i përket burimit të ngrohjes, sipas regjistrimit të vitit 2024 janë vërejtur disa dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale të Kosovës. Përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje ishte më i ulët në zonat urbane, me 45.5 %, krahasuar me 86.3 % në zonat rurale. Në zonat urbane, përdorimi i energjisë elektrike ishte më i theksuar sesa në ato rurale, përkatësisht 44.3 % në zonat urbane, krahasuar me 11.7 % në zonat rurale.

Fig. 12. Burimi kryesor i ngrohjes, 2011





Fig. 13. Burimi kryesor i ngrohjes, 2024



KAPITULLI 3

3.1. Karakteristikat e ekonomive familjare

Në vitin 2011, ekonomitë familjare në Kosovë përbëheshin mesatarisht nga 5.9 persona. Ekonomitë familjare në pjesën urbane të Kosovës ishin më të vogla, me 5.2 persona, ndërsa ato rurale ishin më të mëdha, me 6.4 persona. Deri në vitin 2024, madhësia mesatare e ekonomive familjare kishte rënë ndjeshëm, në një mesatare prej 4.3 personash. Po ashtu, ishte zvogëluar edhe dallimi ndërmjet ekonomive familjare urbane dhe rurale, ku madhësia mesatare e ekonomive familjare urbane ishte 4.1 persona, krahasuar me 4.6 persona në zonat rurale.

Fig. 14: Madhësia e ekonomisë familjare, 2011 dhe 2024





Fig. 15: Ekonomi familjare njëanëtarëshe, 2011 dhe 2024




Ekonomitë familjare njëanëtarëshe përfaqësojnë një kategori të veçantë të ekonomive familjare. Zakonisht ato përbëhen nga persona të moshuar beqarë ose të ve, dhe për shkak se jetojnë vetëm, kanë tendencë më të lartë për të pasur nevojë për asistencë sociale. Regjistrimi i vitit 2011 evidentoi gjithsej 8 556 ekonomi familjare njëanëtarëshe në Kosovë, që përfaqësonin 2.9 % të të gjitha ekonomive familjare. Deri në vitin 2024, kjo përqindje pothuajse ishte trefishuar, duke arritur në 7.0 %.

Përveç madhësisë së ekonomive familjare, edhe përbërja e tyre mund të jetë e rëndësishme për të kuptuar nevojat aktuale dhe të ardhshme për banim. Shtimi i ekonomive familjare që përbëhen nga tre ose më shumë gjenerata mund të jetë tregues në këtë drejtim. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë të disponueshme nga regjistrimi i vitit 2011, prandaj analiza e tanishme bazohet ekskluzivisht në të dhënat e regjistrimit të vitit 2024. Lloji më i zakonshëm i ekonomive familjare në Kosovë në vitin 2024 ishte ekonomia familjare me dy gjenerata, (zakonisht prindër me fëmijë) ku 56.0 % e të gjitha ekonomive familjare i përkasin këtij lloji. Ndërsa, 18.2 % të ekonomive

familjare përbëhej nga një gjeneratë, si dhe pjesa tjetër 25.8 %, përbëhej nga tre ose më shumë gjenerata (zakonisht prindër, fëmijë ose nipër/mbesa dhe gjyshër). Dallimet ndërmjet ekonomive familjare urbane dhe rurale në këtë aspekt ishin mjaft të vogla, ku ekonomitë familjare me një gjeneratë ishin pak më të zakonshme në zonat urbane, ndërsa ekonomitë familjare me tre ose më shumë gjenerata ishin më të përhapura në zonat rurale të Kosovës.

Fig. 16: Numri i gjeneratave në ekonomi familjare, Zona urbane, 2024 **Fig. 17: Numri i gjeneratave në ekonomi familjare Zona rurale, 2024**



Të pasurit tokë në dispozicion mund të jetë e rëndësishme për ekonomitë familjare, qoftë për të siguruar të ardhura, apo për të plotësuar nevojat ushqimore për vetëkonsum. Në vitin 2011, 65.7% e të gjitha ekonomive familjare në Kosovë kishin tokë në dispozicion. Deri në vitin 2024, kjo përqindje kishte rënë në 50.9 %. Rezultatet e regjistrimit të vitit 2024 tregojnë se 32.2 % e ekonomive familjare në zonat urbane të Kosovës kishin tokë në dispozicion, krahasuar me 72.4 % të ekonomive familjare rurale.

Fig 18: Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion, 2011 dhe 2024






Fig. 19: Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion sipas zonave urbane dhe rurale, 2024



Regjistrimet e popullsisë dhe banesave në

Kosovë kanë përfshirë gjithashtu pyetje nëse ekonomitë familjare posedojnë ndonjë lloj bagëtie. Megjithatë, këto të dhëna janë të disponueshme vetëm nga regjistrimi i vitit 2024. Nga të gjitha ekonomitë familjare në Kosovë, 15.1 % raportuan se posedonin bagëti. Në zonat urbane kjo përqindje ishte dukshëm më e ulët, siç edhe mund të pritej, prej 3.2 %. Në zonat rurale, pothuajse një e treta e ekonomive familjare raportuan se posedonin bagëti 28.8%.

Fig. 20: Ekonomitë familjare me bagëti në dispozicion, sipas zonës së banimit, 2024



KAPITULLI 4

4.1. Madhësia dhe struktura e popullsisë

Siç u theksua më herët, të dhënat nga regjistrimet e popullsisë të viteve 2011 dhe 2024 tregojnë një rënie të ndjeshme të numrit të popullsisë në Kosovë. Numri i përgjithshëm i popullsisë ka rënë nga 1 780 024 banorë në vitin 2011 në 1 602 515 banorë në vitin 2024², që përfaqëson një rënie prej **10.0 %** gjatë periudhës 13-vjeçare ndërmjet dy regjistrimeve, ose një mesatare prej 0.8 % në vit.

Dallimet nërmjet meshkujve dhe femrave në këtë drejtim ishin shumë të vogla, ku popullsia mashkullore e Kosovës pësoi një rënie pak më të lartë se ajo femërore, me 9.2 % ose 0.7 % në vit, krahasuar me 8.6 % ose 0.7 % në vit te femrat. Ky dallim u pasqyrua edhe në raportin gjinor të popullsisë (numri i meshkujve për 100 femra), i cili ra nga 101.4 (2011) në 100.7 (2024) gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve të popullsisë.³

Rënia e numrit të popullsisë ishte më e theksuar te popullsia e re e Kosovës (mosha 0-14 vjeç), e cila u zvogëluar me 28.6% %, ose 2.5 % në vit. Një rënie e ngjashme u vërejt edhe te rinjtë (mosha 15-24 vjeç), numri i të cilëve u zvogëluar me 23.6 % nërmjet viteve 2011 dhe 2024, ose 2.1 % në vit. Brenda kësaj grupmoshe (15-24 vjeç), meshkujt ishin më të shumtë në numër, gjë që tregohet nga raportet gjinore rreth 106.5 meshkuj në 100 femra.

Numri i personave në moshë pune (25-64 vjeç) në Kosovë është rritur në mes të viteve 2011 dhe 2024, me 1.0 % ose 0.1 % në vit. Numri i meshkujve shënoi një ngritje më të madhe se ai i femrave, me 1.2 % krahasuar me 0.7 % për femrat. Kjo rezultoi në një rritje të lehtë të raportit gjinor për këtë grupmoshë, nga 97.3 në vitin 2011 në 97.8 % në vitin 2024, ku, femrat vazhdojnë të jenë më të shumta se meshkujt në këtë grupmoshë.

Madhësia e grupmoshës së personave të moshuar (65-79 vjeç) në Kosovë u rrit ndërmjet viteve 2011 dhe 2024 me 49.5 %. Norma mesatare vjetore e rritjes së popullsisë së grupmoshës 65–79 vjeç gjatë periudhës 2011 - 2024 ka qenë rreth 3.1 % në vit. Numri i meshkujve në këtë grupmoshë u rrit me një shkallë më të lartë se ajo e femrave. Rritja e meshkujve në këtë grupmoshë ishte 50.9 %, ose 3.2 % në vit, krahasuar me 48.2 % për femra gjatë intervalit 13-vjeçar, ose 3.1 % në vit. Diferenca ndërmjet meshkujve dhe femrave në madhësinë e popullsisë reflektohet në raportin gjinor për këtë grupmoshë, i cili u rrit nga 90.9 në 92.6. Përkundër shkallës më të lartë të rritjes te meshkujt e moshës 65-79 vjeç, raporti gjinor në këtë grupmoshë mbeti

² Numri i popullsisë sipas Regjistrimeve të Popullsisë të viteve 2011 dhe 2024 përfshin edhe vlerësimet për numrin e banorëve në komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut.

³ Struktura moshore - Grupmoshat janë formuar sipas moshës së plotë të personit në momentin referues të regjistrimit. Raporti gjinor paraqet numrin e meshkujve për çdo 100 femra në grupmoshën përkatëse. Vlerat mbi 100 tregojnë mbizotërim të meshkujve, ndërsa vlerat nën 100 tregojnë mbizotërim të femrave.

dukshëm nën 100, gjë që tregon se ka më shumë femra se meshkuj. Ky është një model i zakonshëm, i shkaktuar kryesisht nga vdekshmëria më e lartë të meshkujt.

Gjithashtu, numri i personave në moshë të shtyrë (80 vjeç e lart) u rrit ndërmjet viteve 2011 dhe 2024. Popullsia në këtë grupmoshë u rrit me 69.4 % gjatë kësaj periudhe, gjë që përkthehet në një shkallë rritjeje vjetore prej 4.2 %. Numri i meshkujve në këtë grupmoshë u rrit me 79.9 %, ose 4.6 % në vit, ndërsa numri i femrave u rrit me 61.9 %, ose 3.8 % në vit. Raporti gjinor në këtë grupmoshë pësoi një rritje, nga 71.2 në 79.1, duke pasqyruar shkallën më të lartë të rritjes së numrit të meshkujve në këtë grupmoshë.

Struktura moshore e popullsisë në Kosovë për vitin 2011 sugjeron një rënie të numrit të fëmijëve, trend ky që kishte filluar rreth 15 vjet më parë. Shpjegimi kryesor për këtë rënie është ulja e nivelit të fertilitetit. Shqyrtimi i strukturës moshore për vitin 2024 tregon një vazhdimësi të këtij trendi.

Struktura moshore e vitit 2024 evidenton gjithashtu ndryshime të theksuara në popullsinë në moshë pune (25–64 vjeç). Si te meshkujt, ashtu edhe te femrat, vërehet një mungesë në grupmoshat 25 deri në 45 vjeç. Një tjetër vëzhgim që mund të bëhet në bazë të strukturës moshore të popullsisë së Kosovës në vitin 2024 lidhet me plakjen e popullsisë. Jo vetëm që përqindjet e personave të moshuar (65-79 vjeç) por dhe atyre në moshë shumë të shtyrë (80+ vjeç) janë konsiderueshëm më të larta se në vitin 2011, por struktura moshore zbulon gjithashtu se femrat janë më të shumta në numër se meshkujt në këto grupmosha.

Fig. 21: Struktura moshore, 2011






Fig. 22: Struktura moshore, 2024



Ndërkohë që përqindja e personave të moshuar dhe atyre në moshë shumë të shtyrë është rritur gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve, përqindja e fëmijëve dhe të rinjve ka pësuar rënie. Në bilancën e përgjithshme, përqindja e popullsisë në moshë pune (të përcaktuar si 25-64 vjeç) është rritur. Megjithatë, kjo do të jetë një dukuri e përkohshme. Rënia e numrit të fëmijëve pritet të stabilizohet, ndërsa rritja e numrit të të moshuarve pritet të përshpejtohet, duke reduktuar kështu numrin dhe përqindjen e popullsisë në moshë pune në të ardhmen.

Fig. 23: Përbërja e popullsisë sipas moshës, 2011 **Fig. 24: Përbërja e popullsisë sipas moshës, 2024**



Duke qenë se popullsia urbane dhe ajo rurale kanë një dallim relativisht të vogël në pjesëmarrjen e tyre në popullsinë e përgjithshme të Kosovës, struktura moshore e popullsisë urbane i ngjan në masë të madhe strukturës moshore të popullsisë së përgjithshme. Në anën tjetër, struktura moshore e popullsisë rurale paraqet parregullsi më të theksuara, të cilat mund të shpjegohen pjesërisht nga ndikimi i migrimit dhe lëvizshmërisë së popullsisë.

Fig. 25: Struktura moshore 2011 urbane




Fig. 26: Struktura moshore 2024 urbane




Fig. 27: Struktura moshore 2011 rurale





Fig. 28: Struktura moshore 2024 rurale



Struktura moshore, e vlerësuar mbi bazën e grup-moshave të gjera, tregon dallime të rëndësishme ndërmjet popullsisë së Kosovës në vitin 2011 dhe asaj në vitin 2024. Duke e zbërthyer analizën për të parë dallimet ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale, vërehet se përqindja e popullsisë në moshë pune në zonat rurale është rritur më shumë se sa në zonat urbane. Megjithatë, kjo pritet të pësojë rënie në të ardhmen, kur grupe më të vogla të të rinjve të hyjnë në moshën e punës. Në vijim të kësaj, vlen të theksohet se tendenca drejt numrit më të vogël të fëmijëve dhe përqindja më e madhe e të moshuarve ishte mjaft e ngjashme si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale të Kosovës.

Fig. 29: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2011 urbane




Fig. 30: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2024 urbane




Fig. 31: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2011 rurale





Fig. 32: Përbërja e popullsisë sipas moshës 2024 rurale



KAPITULLI 5

5.1. Karakteristikat sociale dhe ekonomike

Sipas regjistrimeve të popullsisë të viteve 2011 dhe 2024, përbërja etnike e popullsisë në Kosovë ka ndryshuar lehtë gjatë periudhës ndërmjet dy regjistrimeve.

Pjesa dërmuese e popullsisë deklaruan “shqiptare” si përkatësinë e tyre etnike. Grupi më i madh i pakicave etnike përbëhej nga ata që deklaruan përkatësinë e tyre etnike si “serbe”, boshnjake, turke etj. Gjithashtu, në numër të vogël ishin të pranishëm edhe ashkalinjtë, egjiptianët dhe romët.⁴

Fig. 33: Përkatësia etnike, 2011





Fig. 34: Përkatësia etnike, 2024



Gjuha dhe përkatësia etnike priren të korrespondojnë ngushtë me njëra-tjetrën. Kjo vërtetohet edhe nga të dhënat e regjistrimeve të popullsisë në Kosovë. Shumica dërmuese e popullsisë në Kosovë deklaruan gjuhën shqipe si gjuhën e tyre të zakonshme. Në vitin 2011, 0.7 % përbëhej nga gjuhët të tjera, që do të thotë se ato nuk ishin pjesë e kategorive të formularit të regjistrimit. Në regjistrimin e vitit 2024, kjo kategori ishte më e vogël me 0.6%. Ndonëse në shifra shumë të ulëta, vlen të përmendet se në Kosovë u raportuan edhe gjuha boshnjake, serbe dhe turke.

⁴ Treguesit mbi përkatësinë etnike, gjuhën amtare dhe besimin fetar bazohen ekskluzivisht në vetëdeklarimin e personave të regjistruar. Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk verifikon, nuk interpreton dhe nuk klasifikon identitetin etnik, gjuhësor apo fetar të individëve.

Fig. 35: Gjuha amtare, 2011





Fig. 36: Gjuha amtare, 2024



Në regjistrimin e vitit 2011, si dhe në atë të vitit 2024, shumica dërrmuese e popullsisë në Kosovë deklaruan se besimi i tyre fetarë është islami. Popullsia përfshinte gjithashtu një përqindje të vogël të besimit katolik dhe ortodoks. Pjesa e popullsisë që nuk deklaruan besimin e tyre fetar ishte relativisht i lartë gjatë periudhave regjistruese 2011 dhe 2024.

Fig. 37: Besimi fetar, 2011





Fig. 38: Besimi fetar, 2024



Arsimi është një nga karakteristikat kryesore që përcakton mundësitë e njerëzve në tregun e punës dhe në një kuptim më të gjerë mirëqenien e tyre të përgjithshme. Si një tregues përmbledhës për arsimin, kjo analizë përdor përqindjen e personave në grupmoshën 25-64 vjeç që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose arsimin e lartë. Nivelet e raportuara sipas sistemit të vjetër dhe atij të ri janë bërë të krahasueshme.⁵

⁵ Nivelet arsimore të raportuara në Regjistrimet e Popullsisë 2011 dhe 2024 janë harmonizuar sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED). Për qëllime krahasimi, nivelet e arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit të lartë janë agreguar në kategori të krahasueshme ndërmjet dy regjistrimeve.

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, niveli mesatar i përgjithshëm i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë ose arsimit të lartë në Kosovë u rrit nga 49.5 % në 62.5 %, sipas regjistrimeve përkatëse të popullsisë. Vlera për meshkujt në vitin 2011 ishte 66.5 %, ndërsa ajo për femrat ishte dukshëm më e ulët 32.9. Ndërsa në vitin 2024, këto vlera janë rritur si të meshkujt ashtu edhe të femrat, ku meshkujt prinë me 74.3%, krahasuar me femrat, të cilat shënojnë 51.0%.

Fig. 39: Popullsia e moshës 25-64 me arsim të mesëm të lartë ose arsim të lartë, 2011





Fig. 40: Popullsia e moshës 25-64 me arsim të mesëm të lartë ose arsim të lartë, 2024



Popullsia në moshë pune zakonisht përkufizohet si ajo nga 15 deri në 64 vjeç. Megjithatë, për të qenë konkurrues në tregun e sotëm të punës, arsimi i lartë ose trajnimi po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Përveç kësaj, mund të duhet kohë pasi një i ri përfundon shkollimin përpara se të gjejë punë. Për këto arsye, analiza e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe e punësimit e ndan këtë grupmoshë 15–64 në dy pjesë: 15–24 dhe 25–64 vjeç.

Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për të rinjtë në Kosovë është rritur nga 27.3 % në 35.7 %, Vlen të theksohet se shkalla mesatare e pjesëmarrjes së të rinjve në fuqinë punëtore në vendet evropiane zakonisht sillet në intervalin 40–45%. Shkalla e pjesëmarrjes për femrat e reja ishte dukshëm më e ulët se ajo për të rinjtë meshkuj, përkatësisht 29.5 % kundrejt 41.4 %.

Papunësia e të rinjve në të gjithë Kosovën ishte jashtëzakonisht e lartë në vitin 2011. Në bazë të regjistrimit të vitit 2011, është llogaritur një mesatare kombëtare e papunësisë së të rinjve prej 64.6%. Megjithatë, deri në vitin 2024, shkalla e papunësisë së të rinjve ka rënë ndjeshëm në 19.3%, me një vlerë prej 17.8% për të rinjtë meshkuj dhe 21.5% për të rejtat femra. ⁶

⁶ Normat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe të papunësisë, të paraqitura në këtë publikim, bazohen në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024 dhe në konceptet statistikore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Për shkak të dallimeve metodologjike, këta tregues nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshëm me rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP).

Fig. 41: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore e popullsisë 15-24 vjeç, 2011 dhe 2024





Fig. 42: Shkalla e papunësisë e popullsisë 15-24 vjeç, 2011 dhe 2024



Ndërmjet viteve 2011 dhe 2024, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në mesin e popullsisë së Kosovës të moshës 25–64 vjeç ka shënuar një rritje të lehtë, nga 51.8 % në vitin 2011, në 52.5 % sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024. Në shumicën e vendeve evropiane, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore tejkalon 70 %.

Në Kosovë, dallimet në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ndërmjet viteve 2011 dhe 2024 kanë qenë relativisht të vogla, por me tendencë të ndryshme sipas gjinisë. Tek meshkujt, shkalla e pjesëmarrjes ka shënuar rënie nga 75.5 % në vitin 2011 në 69.2 % në vitin 2024. Në të kundërtën, tek femrat është vërejtur një përmirësim i lehtë, pasi shkalla e pjesëmarrjes është rritur nga 28.6 % në vitin 2011 në 36.1 % në vitin 2024. Megjithatë pjesëmarrja e femrave në tregun e punës ka shënuar progres gjatë periudhës së analizuar, niveli i tyre i pjesëmarrjes mbetet dukshëm më i ulët krahasuar me atë të meshkujve .

Ngjashëm me papunësinë e të rinjve, edhe shkalla e papunësisë në mesin e popullsisë së moshës 25–64 vjeç ishte jashtëzakonisht e lartë në Kosovë në vitin 2011. Gjatë periudhës 2011–2024, tregu i punës ka shënuar përmirësime të konsiderueshme. Shkalla e papunësisë për popullsinë e moshës 25–64 vjeç është ulur nga 40.5 % në vitin 2011 në 12.7 % në vitin 2024. Përmirësim i ndjeshëm është vërejtur edhe tek femrat. Shkalla e papunësisë së femrave të moshës 25–64 vjeç ka rënë nga 50.9 % në vitin 2011 në 20.2 % në vitin 2024,. Megjithatë ky zhvillim tregon progres të rëndësishëm në integrimin e femrave në tregun e punës, niveli i papunësisë së tyre mbetet më i lartë krahasuar me atë të meshkujve.

Fig. 43: Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore sipas moshës 25-64 , 2011 dhe 2024






Fig. 44: Shkalla e papunësisë, moshë 25-64, 2011 dhe 2024



Përveç pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për personat në moshë pune, regjistrimi i popullsisë në Kosovë ka evidentuar gjithashtu aktivitetin ekonomik të popullsisë mbi moshën 65 vjeç. Megjithatë këto shkallë zakonisht janë mjaft të ulëta, ato tregojnë për nevojën ekonomike ose mundësitë për personat e moshuar.

Në Kosovë, shkalla e aktivitetit ekonomik të personave të moshuar (65-84 vjeç) ishte mjaft e ulët në vitin 2024, në 2.1 %, e llogaritur mbi bazën e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024. Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshuar ishte më e lartë në pjesën urbane të Kosovës me 2.8 %, por me një dallim në mes meshkujve dhe femrave. Shkalla e aktivitetit ekonomik për femrat e moshuara në zonën urbane të Kosovës ishte 1.2 % ndërsa në zonen rurale të Kosovës 0.6 %.

Fig. 45: Popullsia ekonomisht aktive 65–84 vjeç, 2024



Lëvizshmëria e njerëzve priret të jetë e lidhur me qasjen e tyre në punë dhe arsim. Të dhënat mbi frekuencën e udhëtimit të rregullt (vajtje-ardhje) ofrojnë një pasqyrë të kësaj qasjeje dhe mund të jenë tregues i nevojës për transport publik.

Përqindja e popullsisë në Kosovë që udhëton në bazë ditore u rrit ndjeshëm në mes viteve 2011 dhe 2024, nga 14.2 % në 24.1 %.. Përqindja e atyre që udhëtojnë më rrallë është rritur gjithashtu gjatë kësaj periudhe, por ka mbetur relativisht e vogël.

Fig. 46: Shpeshtësia e udhëtimit, 2011





Fig. 47: Shpeshtësia e udhëtimit, 2024



Ndonëse regjistrimi i popullsisë zakonisht nuk është i përshtatshëm për të mbledhur të dhëna mbi të ardhurat e popullsisë, burimi i të ardhurave mund të ofrojë informacion të rëndësishëm. Me interes të veçantë në këtë drejtim janë të dhënat mbi përqindjen e personave që mbështeten te pensionet, në përfitime të tjera sociale ose në remitanca si burimin kryesor i të ardhurave. Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura këtu vlejné për të gjithë popullsinë, dhe mund të supozohet se burimi i të ardhurave për të gjithë fëmijët në popullatë do të kategorizohet si “persona të tjerë”.

Shpërndarja e burimeve të të ardhurave të popullsisë në Kosovë pasqyron disa nga tendencat kryesore të vërejtura në pjesët e mëparshme të kësaj analize. Më e rëndësishmja është rritja në mes viteve 2011 dhe 2024 e përqindjes së popullsisë që mbështetet te pensionet, nga 6.4 % në 10.8 %. Përqindja që mbështetet kryesisht në të ardhura nga puna u rrit lehtë gjatë periudhës së regjistrimit nga 22.4 % në 27.4 %. Përqindja e popullsisë që mbështetet te remitancat si burim kryesor i të ardhurave pësoi rënie në mes viteve 2011 dhe 2024.

Fig. 48: Burimi kryesor i të ardhurave, 2011





Fig. 49: Burimi kryesor i të ardhurave, 2024



Në vitin 2011, pjesa e popullsisë që raportonte “personat e tjerë” si burimin e tyre kryesor të të ardhurave ishte pak më e lartë në pjesën urbane të Kosovës. Ndonëse kjo ishte ulur pak deri në vitin 2024, me një përqindje më të vogël se në pjesën rurale të Kosovës. Përqindja e popullsisë që deklaronte punën si burimin e tyre kryesor të të ardhurave ishte konsiderueshëm e ulët në pjesën urban dhe rurale në Kosovë. Kjo ishte rritur ndjeshëm deri në vitin 2024. Rritja e mbështetjes të pensionet si burim kryesor i të ardhurave ishte e ngjashme si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale të Kosovës. Gjithashtu, duhet të theksohet se mbështetja në dërgesat e parave (remitancat) është raportuar të jetë dukshëm më e ulët në zonat urbane krahasuar me zonat rurale të Kosovës.

Fig. 50: Burimi kryesor i të ardhurave në zonat urbane, 2011




Fig. 51: Burimi kryesor i të ardhurave në zonat urbane, 2024




Fig. 52: Burimi kryesor i energjisë ne zonat rurale, 2011





Fig. 53: Burimi kryesor i energjisë ne zonat rurale, 2024



KAPITULLI 6

6.1. Përmbledhje e treguesve të përzgjedhur

Kjo pjesë përfundimtare e profilit të Kosovës paraqet një përmbledhje të vlerave për disa tregues që janë përzgjedhur, të nxjerra nga regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë i vitit 2024, si dhe krahasimet e tyre me regjistrimin e vitit 2011.

Këta tregues mbulojnë të gjitha komunat në Kosovë dhe mesataren në nivel vendi, me qëllim që të mundësohet krahasimi ndërmjet komunave por edhe ndërmjet regjistrimeve 2011 dhe 2024. Këtu paraqiten vetëm vlerat totale, pa ndarje sipas zonave urbane/rurale apo sipas gjinisë (meshkuj/femra). Mesataret kombëtare paraqesin mesatare të peshuara për të gjitha komunat. Duhet theksuar se tregues të ngjashëm të nxjerrë nga burime të tjera të të dhënave mund të kenë vlera të ndryshme.⁷

⁷ Të dhënat për komunat Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe të dhënat për Mitrovicën Veriore janë vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tab. 1 - Popullsia, dendësia dhe urbanizimi sipas komunave, 2024

Komunat	Popullsia 2024	Ndryshimet e popullsisë 2011-2024	Sipërfaqja km²	Dendësia	Popullsia urbane në %	Sipërfaqja urbane
Deçan	27,775	-30.6%	294	94	19.4%	1.1%
Gjakovë	78,699	-16.8%	587	134	56.4%	2.0%
Glllogoc	48,079	-17.9%	276	174	25.6%	2.6%
Gjilan	82,980	-8.0%	392	212	64.2%	3.6%
Dragash	28,896	-15.0%	434	67	4.6%	0.2%
Istog	33,008	-16.0%	454	73	25.6%	1.5%
Kaçanik	27,716	-17.0%	211	131	34.8%	1.4%
Klinë	30,503	-20.8%	309	99	27.0%	1.4%
Fushë Kosovë	63,949	83.6%	84	760	79.6%	8.8%
Kamenicë	22,868	-51.5%	417	55	39.1%	1.2%
Mitrovicë	64,742	-10.0%	331	196	72.0%	3.8%
Leposaviq	9,485	-31.1%	539	18	27.1%	0.2%
Lipjan	55,044	-4.4%	338	163	23.8%	1.3%
Novobërdë	4,493	-33.2%	204	22	5.7%	0.2%
Obiliq	22,815	5.9%	105	218	33.5%	3.7%
Rahovec	41,799	-25.6%	276	152	32.6%	2.0%
Pejë	82,745	-14.2%	603	137	51.4%	2.8%
Podujevë	70,975	-19.8%	633	112	28.6%	1.2%
Prishtinë	227,466	14.4%	523	435	90.1%	8.8%
Prizren	147,246	-17.2%	627	235	61.3%	3.8%
Skenderaj	40,664	-20.0%	374	109	27.5%	0.9%
Shtime	24,308	-11.0%	134	181	30.8%	3.3%
Shtërpcë	10,771	46.7%	248	43	22.6%	0.6%
Suharekë	45,749	-5.0%	361	127	21.6%	1.7%
Ferizaj	109,255	0.6%	345	317	51.2%	4.1%
Viti	35,566	-24.3%	270	132	16.3%	1.4%
Vushtrri	61,528	-24.3%	345	178	47.6%	2.4%
Zubin Potok	3,385	-48.8%	334	10	21.0%	0.3%
Zveçan	2,867	-56.7%	123	23	51.2%	0.8%
Malishevë	43,888	-19.6%	306	143	8.8%	0.8%
Junik	3,943	-35.2%	78	51	99.5%	4.2%
Mamushë	5,607	1.8%	11	513	100.0%	12.4%
Hani i Elezit	8,533	-9.3%	83	103	29.9%	1.1%
Graçanicë	18,486	73.2%	122	151	54.0%	4.4%
Ranillug	2,481	-35.8%	78	32	25.5%	0.6%
Partesh	3,240	81.3%	29	113	37.8%	2.4%
Kllokot	3,041	19.0%	23	130	48.0%	4.7%
Mitrovica Veriore	7,920	19.7%	5	1451	97.0%	34.0%
Kosovë	1,602,515	-10.0%	10,905	147	50.2%	2.3%

Tab. 2 - Kushtet e banimit sipas komunave, 2024

Komunat	Njësiti banesore të banuara	Numri i dhomave për njësi banesore	Numri i përsoneve për dhomë	Sistemi publik i furnizimit me ujë	Sistemi publik i kanalizimit	Tualet me shpërlarje Brenda njësisë së banesës	Ngrohja me lëndë djegëse
Deçan	66.9%	4.9	0.9	81.9	39.0	98.6	83.6
Gjakovë	64.6%	4.4	1.0	95.4	70.9	97.9	59.0
Glllogoc	74.9%	4.3	1.1	42.7	88.9	98.6	74.2
Gjilan	59.5%	4.1	1.0	66.4	82.9	98.1	63.9
Dragash	53.7%	4.7	0.8	56.1	54.2	96.2	93.3
Istog	57.1%	4.3	1.0	91.7	67.4	95.2	82.0
Kaçanik	69.0%	4.2	1.1	74.6	83.5	99.4	83.9
Klinë	58.7%	4.7	1.0	46.0	80.9	98.0	75.5
Fushë Kosovë	60.1%	3.3	1.2	83.8	95.2	96.3	26.4
Kamenicë	61.9%	4.0	0.9	39.0	78.5	89.8	83.9
Mitrovicë	62.8%	3.9	1.1	96.4	86.6	99.3	61.0
Leposaviq	55.1%	2.7	1.0	50.1	38.2	80.9	94.3
Lipjan	62.3%	4.0	1.1	41.2	94.3	98.6	69.4
Novobërdë	61.9%	4.3	1.0	26.9	66.7	91.1	82.4
Obiliq	78.8%	3.6	1.3	86.9	93.4	97.2	75.3
Rahovec	70.2%	4.5	1.0	95.0	93.2	97.0	70.7
Pejë	71.8%	4.2	1.0	88.1	66.7	97.8	61.8
Podujevë	69.7%	3.6	1.3	59.4	89.6	95.1	82.4
Prishtinë	66.2%	3.6	1.0	97.3	97.3	99.4	40.4
Prizren	63.8%	4.4	1.0	89.8	94.1	96.7	64.1
Skenderaj	66.4%	4.1	1.2	61.4	80.1	95.6	76.7
Shtime	70.1%	4.5	1.1	49.9	83.9	99.5	79.4
Shtërpçë	66.3%	3.4	1.0	72.2	76.0	93.3	93.3
Suharekë	57.7%	4.8	0.8	57.5	80.2	95.1	74.6
Ferizaj	60.0%	4.1	1.1	74.8	94.8	98.9	57.6
Viti	58.6%	4.4	1.0	32.0	92.4	99.2	80.7
Vushtrri	64.0%	3.7	1.2	84.8	84.7	98.8	66.3
Zubin Potok	40.4%	3.8	1.0	81.5	79.3	99.5	57.9
Zveçan	18.9%	2.5	1.7	84.6	52.9	100.0	84.6
Malishevë	63.3%	4.6	1.1	36.2	92.9	96.6	77.2
Junik	67.2%	5.6	0.8	99.7	94.9	99.9	73.7
Mamushë	90.7%	5.8	1.0	20.2	92.5	98.6	72.0
Hani i Elezit	82.0%	4.2	1.1	62.8	90.4	99.4	87.6
Graçanicë	76.3%	3.6	1.1	83.0	90.5	98.4	56.3
Ranillug	72.0%	3.1	1.2	39.4	75.2	92.0	94.9
Partesh	73.7%	3.8	0.9	32.6	86.3	93.5	90.1
Kllokot	73.7%	4.0	1.1	29.7	84.5	93.5	83.7
Mitrovica Veriore	58.0%	3.4	0.9	99.9	99.4	100.0	57.0
Kosovë	64.3%	4.1	1.0	76.3%	86.1%	97.6%	64.5%

Tab. 3 - Karakteristikat e ekonomive familjare sipas komunave, 2024

Komunat	Madhësia e Ekonomisë familjare	Ekonomia familjare me një person	3+ gjenerata në ekonomi familjare	% Ekonomitë familjare me tokë në dispozicion	% Ekonomitë familjare me blektori në dispozicion
Deçan	4.7	6.8%	32.9%	85.9%	29.1%
Gjakovë	4.2	7.8%	26.2%	38.1%	16.5%
Glllogoc	4.9	3.2%	32.4%	88.9%	32.8%
Gjilan	4.2	6.0%	25.3%	31.7%	9.1%
Dragash	4.1	7.6%	26.1%	34.1%	7.8%
Istog	4.3	8.0%	24.8%	78.8%	28.8%
Kaçanik	4.7	3.6%	30.8%	54.5%	20.3%
Klinë	4.5	5.6%	28.8%	74.8%	32.4%
Fushë Kosovë	4.0	7.9%	17.8%	33.7%	7.2%
Kamenicë	3.8	8.9%	23.1%	73.5%	22.6%
Mitrovicë	4.2	7.6%	22.8%	33.9%	8.2%
Leposaviq	2.7	28.4%	8.5%	49.5%	24.0%
Lipjan	4.5	4.7%	26.0%	66.9%	28.7%
Novobërdë	4.3	8.1%	25.0%	88.3%	24.3%
Obiliq	4.6	5.1%	25.8%	65.1%	21.7%
Rahovec	4.6	5.3%	32.1%	67.8%	14.1%
Pejë	4.2	9.7%	25.3%	53.1%	13.8%
Podujevë	4.8	4.1%	30.6%	82.7%	26.4%
Prishtinë	3.9	9.8%	18.0%	32.4%	3.0%
Prizren	4.5	6.7%	31.8%	41.4%	6.9%
Skenderaj	4.8	4.9%	31.8%	69.5%	35.7%
Shtime	5.0	3.0%	34.8%	69.6%	26.9%
Shtërpcë	3.6	15.5%	19.0%	31.4%	7.7%
Suharekë	4.1	6.1%	23.0%	66.2%	16.1%
Ferizaj	4.5	5.4%	27.4%	43.2%	13.3%
Viti	4.5	4.8%	29.5%	57.1%	27.6%
Vushtrri	4.4	5.1%	25.6%	55.9%	19.1%
Zubin Potok	4.0	9.4%	22.5%	80.1%	31.4%
Zveçan	4.1	11.4%	21.0%	73.3%	36.2%
Malishevë	5.1	3.0%	34.5%	88.4%	24.9%
Junik	4.4	8.4%	28.0%	76.5%	21.9%
Mamushë	6.4	2.1%	45.6%	45.0%	7.7%
Hani i Elezit	4.9	3.1%	32.4%	26.1%	8.1%
Graçanicë	4.5	8.4%	21.7%	49.0%	15.3%
Ranillug	3.8	12.4%	27.0%	73.7%	38.1%
Partesh	3.5	12.5%	21.2%	63.8%	35.9%
Kllokot	4.6	6.9%	33.3%	51.4%	42.9%
Mitrovica Veriore	3.2	23.0%	9.7%	8.2%	1.0%
Kosovë	4.3	7.0%	25.8%	50.9%	15.1%


Tab. 4 - Ndryshimet demografike sipas grupmoshave dhe komunave, 2011 dhe 2024

Komunat	Ndryshimi i popullsisë 0-14	Ndryshimi i popullsisë 15-24	Ndryshimi i popullsisë 25-64	Ndryshimi i popullsisë 65-79	Ndryshimi i popullsisë 80+	% Udhëtimi i përditshëm (vajtje-ardhje në punë)
Deçan	-46%	-47%	-23%	20%	43%	14.6%
Gjakovë	-38%	-35%	-6%	41%	55%	24.0%
Glllogoc	-32%	-34%	-8%	37%	45%	22.5%
Gjilan	-30%	-27%	5%	36%	79%	25.2%
Dragash	-38%	-30%	-6%	33%	33%	11.0%
Istog	-39%	-29%	-6%	37%	55%	21.3%
Kaçanik	-33%	-28%	-9%	38%	42%	20.6%
Klinë	-40%	-36%	-9%	36%	55%	17.0%
Fushë Kosovë	65%	52%	101%	128%	139%	32.0%
Kamenicë	-58%	-52%	-29%	16%	30%	20.4%
Mitrovicë	-28%	-15%	-5%	43%	64%	22.1%
Leposaviq	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	7.4%
Lipjan	-23%	-13%	5%	49%	57%	24.7%
Novobërdë	-35%	-40%	-29%	-36%	-33%	23.7%
Obiliq	-15%	-1%	13%	72%	112%	25.8%
Rahovec	-44%	-42%	-15%	35%	39%	16.3%
Pejë	-33%	-27%	-9%	40%	72%	23.4%
Podujevë	-40%	-23%	-13%	37%	58%	21.2%
Prishtinë	-2%	-2%	20%	77%	113%	35.8%
Prizren	-35%	-34%	-8%	42%	53%	23.5%
Skenderaj	-40%	-33%	-8%	25%	52%	17.1%
Shtime	-33%	-20%	3%	37%	55%	20.7%
Shtërpcë	-1%	31%	68%	182%	139%	7.5%
Suharekë	-45%	-40%	-10%	28%	43%	20.8%
Ferizaj	-21%	-10%	10%	59%	90%	26.4%
Viti	-45%	-32%	-13%	20%	44%	20.2%
Vushtrri	-29%	-25%	-4%	41%	68%	21.9%
Zubin Potok	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.7%
Zveqan	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.0%
Malishevë	-40%	-32%	-2%	26%	37%	15.6%
Junik	-60%	-46%	-26%	23%	47%	14.7%
Mamushë	-23%	-7%	20%	47%	70%	27.9%
Hani i Elezit	-25%	-22%	0%	43%	16%	17.0%
Graçanicë	38%	59%	83%	132%	168%	25.8%
Ranillug	-38%	-54%	-31%	-31%	-22%	12.6%
Partesh	41%	5%	106%	164%	321%	8.6%
Kllokot	-6%	-18%	46%	37%	174%	12.5%
Mitrovica Veriore	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	23.3%
Kosovë	-28.6%	-23.6%	1.0%	49.5%	69.4%	24.1%

Tab. 5 - Karakteristikat socio-ekonomike të popullsisë sipas komunave, 2024


Komunat	% Arsimi i mesëm i lartë dhe i lartë 25-64	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 15-24	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 25-64	Papunësia Moshë 15-24	Papunësia Moshë 25-64	Ekonomikisht aktive 65-84	Burimi i të ardhurave nga puna	Burimi i të ardhurave nga pensionet	Burimi i të ardhurave nga Remitancat
Deçan	56.3%	28.0%	37.4%	27.9%	23.8%	1.0%	19.2%	14.4%	4.4%
Gjakovë	56.8%	36.5%	52.3%	22.1%	14.2%	2.7%	27.1%	13.5%	4.4%
Glogoc	58.9%	39.4%	50.2%	19.4%	17.2%	1.0%	24.0%	10.9%	3.2%
Gjilan	65.9%	39.6%	58.1%	23.0%	15.8%	2.1%	28.0%	10.9%	3.1%
Dragash	42.9%	24.6%	32.6%	47.1%	29.3%	1.6%	15.7%	12.8%	2.9%
Istog	56.3%	32.5%	46.5%	18.8%	12.6%	1.7%	29.1%	11.4%	4.2%
Kaçanik	62.2%	37.4%	47.9%	24.4%	18.6%	1.5%	21.7%	10.3%	2.8%
Klinë	47.7%	31.3%	41.6%	27.3%	20.9%	1.7%	18.7%	12.1%	6.2%
Fushë Kosovë	72.8%	44.3%	64.7%	10.6%	7.0%	2.4%	35.2%	7.4%	1.6%
Kamenicë	61.7%	34.7%	46.9%	25.8%	19.7%	1.4%	24.0%	14.5%	4.3%
Mitrovicë	66.8%	40.0%	55.5%	26.8%	19.0%	1.8%	25.1%	12.5%	1.7%
Leposaviq	56.5%	19.2%	37.8%	75.4%	41.3%	2.5%	17.4%	20.7%	0.3%
Lipjan	60.7%	39.5%	51.2%	13.4%	11.0%	1.2%	26.4%	9.2%	2.5%
Novobërdë	58.8%	36.4%	51.6%	15.2%	12.6%	1.6%	27.2%	11.1%	1.7%
Obiliq	68.5%	34.1%	54.1%	11.4%	9.2%	0.7%	27.9%	8.6%	1.4%
Rahovec	40.8%	26.6%	37.3%	26.5%	12.6%	2.3%	28.4%	9.5%	6.5%
Pejë	66.5%	32.1%	51.1%	19.3%	10.6%	3.2%	27.2%	12.9%	2.9%
Podujevë	58.4%	35.3%	47.3%	20.6%	13.8%	1.2%	24.8%	10.3%	3.6%
Prishtinë	82.9%	39.1%	69.9%	8.7%	5.7%	3.4%	38.7%	10.1%	0.9%
Prizren	49.1%	33.1%	48.7%	18.9%	11.3%	2.1%	25.9%	10.2%	5.5%
Skenderaj	52.4%	32.5%	42.1%	27.7%	21.0%	0.9%	18.1%	13.4%	3.2%
Shtime	59.7%	36.8%	44.8%	19.9%	14.7%	1.1%	24.2%	8.6%	4.1%
Shtërpçë	79.6%	32.1%	47.7%	58.5%	54.1%	1.6%	17.3%	18.0%	0.5%
Suharekë	49.6%	31.1%	44.9%	22.0%	12.1%	1.5%	25.6%	10.6%	7.8%
Ferizaj	66.9%	38.6%	53.2%	14.0%	10.4%	2.2%	27.9%	9.0%	2.5%
Viti	59.7%	34.4%	47.0%	27.4%	17.4%	1.6%	22.2%	9.8%	5.2%
Vushtrri	65.4%	36.1%	51.1%	17.4%	12.7%	1.8%	27.5%	11.3%	1.7%
Zubin Potok	68.5%	32.5%	51.6%	24.4%	7.3%	1.9%	24.4%	12.2%	4.1%
Zveçan	65.9%	32.8%	52.3%	20.0%	8.0%	6.3%	25.3%	9.4%	1.2%
Malishevë	39.1%	32.0%	39.8%	32.6%	18.7%	0.7%	18.0%	7.9%	9.1%
Junik	50.8%	22.3%	29.3%	16.2%	9.3%	0.8%	20.7%	15.5%	1.4%
Mamushë	26.9%	28.6%	48.6%	5.5%	1.2%	4.4%	28.8%	5.6%	1.7%
Hani i Elezit	54.9%	19.2%	31.5%	8.4%	4.9%	0.8%	15.9%	9.3%	3.1%
Graçanicë	83.3%	32.2%	62.6%	28.9%	15.0%	6.0%	27.1%	11.2%	0.2%
Ranillug	77.1%	17.5%	38.4%	43.1%	20.9%	0.7%	35.3%	18.7%	0.4%
Partesh	80.8%	23.1%	47.5%	86.5%	59.6%	1.1%	26.6%	16.8%	0.1%
Klokot	64.2%	35.7%	47.9%	49.7%	46.0%	1.6%	19.4%	9.6%	0.5%
Mitrovica Veriore	80.5%	26.2%	49.0%	9.0%	10.3%	1.6%	24.2%	19.3%	1.5%
Kosovë	62.5%	35.7%	52.5%	19.3%	12.7%	2.1%	27.4%	10.8%	3.3%

Harta. 4: Shkalla e punësimit sipas komunave, 2024⁸



⁸ Treguesit e tregut të punës të paraqitur në këtë publikim bazohen në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024 dhe, për shkak të dallimeve metodologjike, nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshëm me rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP).

Harta. 5: Shkalla e papunësisë sipas komunave, 2024



Fjalor i Termave

Përkufizimet kryesore të temave - variablat e përgjithshme

Regjistrimi

Regjistrimi është procesi zyrtar i numërimit që kryhet nga një shtet në një kohë të caktuar për të gjithë popullsinë (personat), duke mbledhur të dhëna demografike, ekonomike, sociale, arsimore, bujqësore dhe informata të tjera për secilin individ. Regjistrimi në Kosovë është realizuar përmes intervistave ballë për ballë (*face-to-face*), ku të dhënat janë mbledhur për çdo ekonomi familjare/individ.

Popullsia rezidente

Popullsia rezidente përfshin të gjithë individët që kanë vendbanimin e zakonshëm në territorin e një vendi dhe qëndrojnë ose kanë qëndruar për të paktën 12 muaj, ose që kanë qëllim të qëndrojnë për një periudhë të tillë.

Popullsia jo-rezidente

Popullsia jo-rezidente përfshin individët që kanë vendbanim të zakonshëm jashtë Kosovës, por që ndodhen përkohësisht brenda territorit të saj për qëllime si puna, studimet, turizmi ose vizitat familjare. Sipas standardeve ndërkombëtare, këta persona nuk përfshihen në statistikat e popullsisë rezidente të Kosovës, por mund të regjistrohen për qëllime statistikore të veçanta, si vlerësimi i flukseve të migrimit, analizat ekonomike dhe studimet mbi shërbimet publike të ofruara për këtë kategori.

Ekonomia familjare

Ekonomia familjare nënkupton individin, bashkësinë familjare ose një bashkësi tjetër personash (individësh), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur plotësisht ose pjesërisht në një njësi banesore, si dhe furnizohen me gjëra ushqimore dhe gjëra të tjera esenciale për jetesë. Anëtarët e këtij grupi mund të bashkojnë të ardhurat e tyre në një masë më të madhe ose më të vogël.

Ekonomia familjare institucionale-kolektive

Ekonomia institucionale përfshin personat të cilët kanë nevojë për strehë dhe ekzistencë, e cila u sigurohet nga një institucion. Institucioni nënkuptohet të jetë një organ ligjor për qëllime të banimit afatgjatë, që ofron shërbime për një grup personash. Këto institucione zakonisht kanë pajisje të përbashkëta që ndahen nga banorët (si banjat, dhomat e ndejës, dhomat e ngrënies, dhomat e fjetjes, etj.).

Ekonomitë familjare institucionale janë grupuar në kategoritë vijuese:

- Vendbanime/konvikte për studentë
- Spitale dhe sanatoriume
- Shtëpi përkujdesi
- Objekte për persona me aftësi të kufizuara
- Institucione psikiatrike
- Shtëpi për të moshuar
- Shtëpi për fëmijë dhe jetimore
- Kazerma ushtarake dhe policore
- Burgje dhe shtëpi korrektimi
- Manastire
- Shtëpi për punëtorë
- Kampe refugjatësh
- Të tjerë (përfshirë objektet e strehimit të asistuar dhe institucionet e mirëqenies).

Ekonomitë familjare institucionale zakonisht gjenden brenda kuarteve të banimit kolektiv.

Familja

Familja përkufizohet si dy ose më shumë persona, të cilët jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare dhe që janë të lidhur si burrë dhe grua (ose partnerë që bashkëjetojnë) me ose pa fëmijë, ose prind me një fëmijë. Prandaj, koncepti i familjes përfshin:

- Një çift pa fëmijë;
- Një çift me një ose më shumë fëmijë të pamartuar;
- Një prind i vetëm me një ose më shumë fëmijë të pamartuar.

Ndërtesë

Ndërtesë është çdo strukturë e pavarur që përmban një ose më shumë banesa, dhoma ose hapësira të tjera, që është e mbuluar me kulm dhe e mbyllur me mure, ose e ndarë me mure të brendshme, të cilat shtrihen prej themeleve deri në kulm. Ndërtesat mund të jenë të destinuara për qëllime banimi, bujqësore, komerciale, industriale, kulturore ose për ofrimin e shërbimeve të tjera.

Urbane

Zonë e urbanizuar gjeografike e definuar në nivel vendbanimi, e cila karakterizohet me densitet më të lartë të popullsisë krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë, një zonë përkufizohet si urbane përmes vendimit administrativ të komunës përkatëse.

Rurale

Zonë gjeografike jo e urbanizuar, e përkufizuar në nivel vendbanimi, që karakterizohet me densitet më të ulët të popullsisë. Zakonisht, shumica e tokës në këto zona shfrytëzohet për bujqësi, krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë, një zonë përkufizohet si rurale përmes vendimit administrativ të komunës përkatëse.

Karakteristikat kryesore të ndërtesave

Ndërtesë banimi

Ndërtesë e dizajnuar ose dedikuar për banim.

Shtëpi e veçuar e ndarë në vete

Shtëpi individuale që nuk është e ngjitur me asnjë objekt tjetër.

Shtëpi gjysmë e ndarë

Dy banesa të cilat janë të bashkuara me një mur të përbashkët.

Resht apo varg shtëpish

Ndërtesë që përbëhet nga tre ose më shumë banesa në varg, ku secila prej tyre ka dalje të veçantë. Ndërtesë apo blloqe apartamentesh, janë bllok i banesave, të cilat kanë tre ose më shumë banesa, të cilat kanë dalje të përbashkët;

Ndërtesë që nuk është për banim

Ndërtesë e cila, nga dukja e jashtme, nuk është destinuar për banim dhe përbëhet vetëm ose kryesisht nga njësi të përdorura për qëllime bujqësore, komerciale ose për ofrimin e shërbimeve si xhami, kishë, fabrikë, etj.

Numri i kateve të ndërtesës

Numri i kateve numërohet duke filluar nga kati përdhes e lart, duke përfshirë edhe katin përdhes (i cili llogaritet si kati numër një).

Viti i ndërtimit të ndërtesës

Viti i ndërtimit të ndërtesës konsiderohet viti i përfundimit të saj ose viti kur ndërtesa ka pësuar ndryshime të mëdha ndërtimore. Për një banesë të përfunduar që ndodhet në një ndërtesë të papërfunduar, shënohet viti i përfundimit të ndërtimit të banesës.

Karakteristikat kryesore të banesave/njësive të banimit

Banesa e zakonshme

Banesa e zakonshme përkufizohet si një dhomë ose tërësi dhomash me pjesët përcjellëse të tyre (p.sh., paradhoma, korridore, etj.) në një ndërtesë të përhershme ose strukturë të ndarë e cila është planifikuar (ose shndërruar) për banim të përhershëm. Banesa duhet të jetë: E rrethuar me mure dhe e mbuluar me kulm; të ketë qasje direkte nga një rrugë, shkallë publike/komunale, shteg, galeri ose tokë (d.m.th., ku shfrytëzuesit mund të hyjnë dhe të dalin pa kaluar nëpër dhomat ose shtëpitë e ndonjë ekonomie tjetër familjare).

Njësiti e tjera banesore

Njësiti e tjera banesore përfshijnë njësi që janë:

- Të lëvizshme (p.sh., tenda ose dhoma rimorkio);
- Gjysmë të përhershme (p.sh., kabina ose kasolle);
- Të improvizuara (p.sh., streha ose baraka);
- Nuk janë të destinuara për banim (p.sh., garazhe, shitore, strehime natyrore), por që në kohën e regjistrimit përdoren si banim i zakonshëm nga një ose më shumë persona.

Banesa të banuara (statusi i shfrytëzimit të banesës/shtëpisë)

Për secilën ekonomi familjare që jeton në një banesë, duhet të përcaktohet statusi i shfrytëzimit të njësisë banesore.

E shfrytëzuar nga banorë që nuk përfshihen në regjistrim

Banesa është e banuar nga persona që nuk përfshihen në regjistrimin e popullsisë, si personeli diplomatik, personeli i huaj ushtarak dhe EULEX-i.

E shfrytëzuar për qëllime të përkohshme ose përdorim dytësor

Banesa shfrytëzohet për qëllime të përkohshme ose si banesë dytësore (p.sh. punë sezonale, pushime etj.).

Banesë e dedikuar për qëllime biznesi

Banesat që gjatë kohës së regjistrimit janë të shfrytëzuara për qëllime biznesore, si avokaturë, ordinancë mjekësore etj.

Banesë e pabanuar

Banesat që gjatë kohës së regjistrimit janë të përshtatshme për banim, por janë të pabanuara, të lira ose të dedikuara për shitje, qira, prishje apo të blera nga persona që kanë vendbanim diku tjetër.

Banesë/shtëpi e ndarë, e shfrytëzuar nga e njëjta ekonomi familjare

Banesat ose shtëpitë që janë të ndara, por të shfrytëzuara nga e njëjta ekonomi familjare.

Banesë/shtëpi e pabanuar (jashtë vendit)

Banesat ose shtëpitë ku ekonomia familjare jeton jashtë vendit.

Numri i ekonomive familjare në njësinë banesore

Numri i ekonomive familjare që jetojnë në një njësi banesore.

Numri i personave me vendbanim të zakonshëm në njësinë banesore

Numri i personave që kanë vendbanim të zakonshëm në këtë njësi banesore.

Numri i dhomave në dispozicion duke përfshirë edhe dhomat për qëllime biznesi ose profesionale**Dhoma**

Një dhomë është njësi hapësinore e banesës për banim, e ndarë nga dhomat e tjera me mure të qëndrueshme (nga dyshemeja në tavan ose kulm), me një lartësi minimale prej 2 m dhe madhësi të mjaftueshme për të zënë një shtrat për të rritur (së paku 4 metra katrorë).

Në numrin e përgjithshëm të dhomave përfshihen:

- Dhomat e zakonshme të fjetjes dhe të ndejës;
- Bodrumet e banueshme dhe nënçatitë;
- Kuzhinat dhe hapësirat e tjera të ndara, që shfrytëzohen për banim.

Nuk përfshihen:

- Kuzhinat më të vogla se 4 m² (aneksi i kuzhinës);
- Verandat, dhomat e pajisjeve (p.sh. dhomat e bojlerëve dhe të larjes së rrobave);
- Paradhomat dhe banjat apo tualetet (edhe nëse janë më të mëdha se 4 m²).

Dhomat e ndara nga banesa, por që janë në funksion të saj dhe shfrytëzohen nga ekonomia familjare, konsiderohen si pjesë e banesës.

Dhoma për qëllime biznesi ose profesionale

Dhomat që janë pjesë e banesës, por përdoren kryesisht për qëllime biznesi, si dyqane, zyra apo punishte.

Sistemi kryesor i furnizimit me ujë në njësinë e banesës është dallimi ndërmjet banesave të cilat kanë ose që nuk kanë sistem të furnizimit me ujë përmes sistemit të ujësjellësit.

Sistemi i furnizimit me ujë nga një shërbim publik

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) dhe shpërndahet nga ofruesi publik i shërbimit (shembull i kësaj është sistemi i ujësjellësit komunal).

Sistemi i furnizimit me ujë nga shërbimet tjera

Furnizimi me ujë bëhet përmes gypave (uji nga rubineti) por nuk shpërndahet sipas skemës së shërbimit publik. Kjo ndodhë në rastet kur uji silltet në shtëpi përmes pompave prej ndonjë pusi/bunar (veçanërisht në zonat rurale, hidrofor) ose prej ndonjë ujëvare natyrore/ rënie e lirë (veçanërisht në zonat malore).

Sistemi i furnizimit me ujë brenda ndërtesës, por jashtë njësisë së banesë

Kjo ndodhë në rastet kur furnizimi me ujë ekziston në ndërtesë, por jo edhe në njësinë banesore. Furnizimi me ujë mund të jetë i përbashkët për disa banesa brenda ndërtesës.

Sistemi i furnizimit me ujë jashtë ndërtesës

Qasja në ujë ekziston vetëm jashtë ndërtesës.

Nuk ka sistem të furnizimit me ujë

Nuk ka fare sistem të furnizimit me ujë (as në njësinë banesore e as jashtë ndërtesës).

Shkarkimi i ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit të lidhur me sistemin publik

Ekonomitë familjare të cilat në banesë kanë shkarkim të ujërave të zeza përmes kanalizimit të lidhur me sistem publik.

Shkarkimi i ujërave të zeza nëpërmjet kanalizimit të lidhur me sistemin privat

Ekonomitë familjare të cilat në banesë kanë shkarkim të ujërave të zeza përmes kanalizimit të lidhur me sistem privat.

Të gjitha mënyrat e tjera (p.sh. kanal, gropë septike, lumë etj.)

Rastet kur shkarkimi i ujërave të zeza nuk bëhet nëpërmjet sistemit të kanalizimit, por në kanale, gropa septike, lumenj etj.

Nuk ka sistem kanalizimi. Njësia banesore nuk ka fare sistem për shkarkimin e ujërave të zeza.

Tualet me shpëlarje brenda njësisë së banesës

Njësia banesore posedon tualet me shpëlarje brenda njësisë së banesës.

Tualet me shpëlarje jashtë njësisë së banimit por brenda ndërtesës

Ka tualet me shpëlarje brenda ndërtesës por jashtë njësisë së banimit.

Tualet me shpëlarje jashtë ndërtesës

Qasja në tualet me shpëlarje ka vetëm jashtë ndërtesës.

Nuk ka tualet me shpëlarje

Nuk ka tualet me shpëlarje (veçanërisht në zonat rurale) dhe mund të përdoren një lloj tjetër tualetesh (të ashtuquajturat 'nevojtores').

Me dush apo vaskë të fiksuar

Banesat që kanë të paktën një dush ose vaskë të fiksuar.

Pa dush apo vaskë të fiksuar

Banesat ku mungon dushi ose vaska e fiksuar.

Kuzhina

Definohet si një dhomë (ose pjesë e një dhome) me së paku 4 m², e projektuar dhe pajisur për përgatitjen e ushqimeve kryesore, pavarësisht nëse përdoret edhe për ngrënie, fjetje ose banim.

Aneks kuzhine

Kuzhinë më e vogël se 4 m².

Ngrohja qendrore nga sistemi i ngrohjes publike.

Ngrohja qendrore sigurohet përmes një sistemi publik (ngrohtore).

Ngrohja qendrore nga sistemi i instaluar brenda ndërtesës ose njësisë banesore.

Ngrohja qendrore sigurohet përmes pajisjeve të instaluara privatisht në ndërtesë ose në vetë njësinë banesore.

Stufa

Aparat i lëvizshëm ose i fiksuar që përdoret për ngrohje ose gatim.

Oxhaku/Kamini

Strukturë e hapur në dhomë, zakonisht në mur, e përdorur për ndezjen e zjarrit.

Ngrohëse elektrike e lëvizshme. Aparat elektrik i lëvizshëm që përdoret për ngrohje.

Të tjera. Për shembull, sistemi i ngrohjes solare.

Pa ngrohje

Banesat që nuk kanë asnjë lloj sistemi ngrohjeje.

Lloji kryesor i energjisë që përdoret për ngrohje

I referohet llojit të energjisë që përdoret më shpesh nga ekonomia familjare për ngrohjen e njësisë banesore. Nëse përdoren disa lloje të energjisë, shënohet ai që përdoret më shumë.

Struktura/Përbërja e Ekonomive Familjare

Anëtar i ekonomisë familjare

Çdo person që ka banim të zakonshëm në një ekonomi familjare.

Ekonomia familjare me një anëtar

Ekonomi familjare që përbëhet nga një person i vetëm, i cili:

- jeton i vetëm në një njësi banesore, ose
- banon si qiraxhi në një dhomë të ndarë të njësisë banesore, por nuk bashkohet me asnjë banues tjetër për të formuar një ekonomi familjare me më shumë persona.

Ekonomia familjare shumë anëtarëshe

Grup prej dy ose më shumë personash, të cilët mund të jenë ose jo të afërt me njëri-tjetrin dhe që jetojnë së bashku për të shfrytëzuar plotësisht ose pjesërisht një njësi banesore. Ata sigurojnë së bashku ushqim dhe gjëra të tjera të nevojshme për jetesë, ndërsa mund të bashkojnë të ardhurat në shkallë më të madhe apo më të vogël.

Ekonomia familjare pa asnjë familje

Ekonomi familjare ku:

- jeton një person i vetëm, ose
- banesa ndahet vetëm me persona jo të afërt sipas përkufizimit të regjistrimit (p.sh., bashkëbanuesit, partnerët e pamartuar, vëllezërit etj.).

Ekonomia familjare me një familje

Ekonomi familjare e përbërë vetëm nga një familje.

Karakteristikat kryesore të ekonomive familjare

Statusi i shfrytëzimit të banesës

Anzhanimi sipas të cilit ekonomia familjare e shfrytëzon njësinë e banimit.

Formë tjetër e shfrytëzimit

Ekonomia familjare e shfrytëzon tërë apo një pjesë të njësisë së banimit sipas ndonjë forme të veçantë të shfrytëzimit, p.sh., kur njësi banesore i është dhënë ekonomisë familjare pa pagesë nga punëdhënësi ose nga ndonjë i afërm.

Toka në pronësi apo në shfrytëzim

Të gjitha sipërfaqet e tokës që janë në pronësi ose në shfrytëzim nga ekonomia familjare. Toka e regjistruar nuk duhet domosdoshmërisht të jetë në të njëjtën komunë ku jeton ekonomia familjare; ajo mund të jetë edhe në ndonjë komunë tjetër të Kosovës.

Karakteristikat kryesore të personave

Gjinia biologjike

Term që përdoret për të përshkruar karakteristikat fiziologjike dhe gjenetike që përcaktojnë nëse një individ është mashkull ose femër nga pikëpamja biologjike.

Përkatësia etnike

Bazohet në kuptimin e përbashkët të historisë dhe origjinës territoriale (regjionale, kombëtare) të një grupi etnik apo komuniteti. Përkatësia etnike përfshin edhe karakteristika kulturore si: gjuha, besimi fetar, traditat specifike dhe/ose mënyra e jetës.

Besimi fetar

Përmbledhje e sistemeve kulturore, sistemeve të besimit dhe pikëpamjeve botërore që lidhin njerëzimin me vlerat shpirtërore dhe ndonjëherë edhe ato morale.

Gjuha amtare

Gjuha e parë që personi ka folur në fëmijërinë e hershme dhe të cilën ende e flet. P.sh., gjuha që personi e konsideron si gjuhën amtare, pavarësisht nëse e përdor ende apo jo.

Vendi i shtetësisë

Shteti me të cilin personi ka një lidhje të veçantë ligjore, e cila është fituar sipas lindjes ose natyralizimit, qoftë përmes deklaramentit, zgjedhjes, martesës ose ndonjë mënyre tjetër të përcaktuar nga legjislati shtetëror.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Drejtori Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është
institucioni qendror i Republikës së Kosovës
për prodhimin, zhvillimin dhe shpërndarjen
e statistikave zyrtare cilësore,
në përputhje me standardet profesionale.

Ne ofrojmë të dhëna për të kuptuar të tashmen
dhe për të planifikuar të ardhmen.



PËR MË SHUMË INFORMATA

vizitoni uebfaqen tonë:

www.ask.rks-gov.net

NA NDIQNI

